



Marrëveshje Bashkëpunimi

Në mes të

1. **Organizata "Kujdesi për Jetimët e Kosovës"** me seli në Prishtinë dhe me nr. të veprimtarisë: 5200483-7
2. **Komuna e Hanit të Elezit**, Adresa: Rr" Nuri Bushi" Nr 2, Hanë e Elezit

Palët lidhin marrëveshjen si në vijim:

Neni 1

Objektivi i Marrëveshjes

Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet në mes të Organizates "Kujdesi për Jetimët e Kosovës" përfaqësuar nga **Fadil Pushkolli, Kryetar** dhe Komunës së Hanit të Elezit përfaqësuar nga **Rufki Suma, Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit**, me qëllim të realizimit të projektit për ndarje të bursave.

Neni 2

Qëllimi i Marrëveshjes

Kjo marrëveshje ka për qëllim vendosjen e bashkëpunimit në mes të dy entiteteve për realizimin e ndihmës me anë të bursës për 15 femijë nga Komuna e Hanit të Elezit.

Neni 3

Mënyra e Bashkëpunimit

Me qëllim të implementimit të kësaj marrëveshje Organizata "Kujdesi për Jetimët e Kosovës" si dhe Komuna e Hanit te Elezit do të ndërmarrim veprimet si më poshtë:

- **Organizata "Kujdesi për Jetimët e Kosovës"** do të siguroj bursë mujore me shumë 30 Euro, për çdo fëmijë.
- **Organizata "Kujdesi për Jetimët e Kosovës"** do ti ndihmoj fëmijet, në bazë të mundësive ekonomike të organizatës, duke përfshirë ndihmën me mjete shkollore, kurse të nryshme edukativo- arsimore, shetitje etj.
- **Komuna e Hanit te Elezit** obligohet të siguroj një listë me infromta të sakta për 15 femijë jetim, nga Komuna e Hanit te Elezit. Fëmijët duhet të jenë deri në moshën 12 vjecare, pa prindin babë.

Neni 4

Përdorimi i informatave dhe dokumenteve

Asnjëra palë nuk duhet të shpërndaj apo të bëj publike asnjë informatë të marrë apo dokument të dhënë nga pala tjetër për qëllime të tjera, jashtë kësaj marrëveshje bashkëpunimi pa miratimin me shkrim paraprak nga pala tjetër.

Palët do ta trajtojnë në mënyrë konfidenciale çdo informatë, si dhe komunikimet verbale të shkëmbyera në mes tyre, sipas kësaj marrëveshje bashkëpunimi.

Neni 5

Interpretimi dhe Ndryshimi

Amandamenti i kësaj marrëveshje do të bëhet në bazë të iniciativave të dyanshme, në mënyrë të shkruar, lidhur me nevojat e kohës që paraqiten në zbatim të kësaj marrëveshje bashkëpunimi.

Neni 6

Kohëzgjatja dhe Shkëputja e Marrëveshjes

Kohëzgjatja e marrëveshjes do të jetë e pakufizuar. Në rast kontesti eventual palët mund të kërkojnë shkëputjen e kësaj marrëveshje duke njoftuar palën tjetër 30 (Tridhjetë) ditë para shkeputjes së marrëveshjes.

Neni 7
Hyrja në Fuqi

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe është e përpiluar në katër (4) kopje identike ku secila palë mban nga dy kopje.

Data e Nënshkrimit: 01.12.2020

Organizata "Kujdesi për Jetimët e Kosovës"



Fadil Pishkollari – Kryetar


Komuna e Hanit të Elezit



Rufki Suma – Kryetar
